VENDIM
Nr.526, datë 27.4.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.90, DATË 28.1.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGAT E ATASHEVE USHTARAKË, TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QË SHËRBEJNË NË PËRFAQËSITË USHTARAKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË NATO-S, NË SHTABET E NATO-S, NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE DHE SHTABET USHTARAKE NDËRKOMBËTARE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, të nenit 20 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 "Për buxhetin e vitit 2009", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 1 të vendimit nr.90, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare për vitin 2009, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të këtij viti, të planifikuara për Ministrinë e Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Emërtimi	**Paga në euro**	**Paga në dollarë**	**Shtesa për përfaqësimin (në%)**
Përfaqësitë e NATO-s			
Gj.Lejtnant	1170	1410	75%
Gj.Major	1145	1365	60-75%
Gj.Brigade	1070	1285	60-75%
Përfaqësitë e tjera			
Kolonel	960	1165	40-60%
Nënkolonel	910	1100	40-60%
Major	865	1050	40%
Kapiten	805	1020	40%
Toger	760	925	40%
Nëntoger	705	875	40%
K/kapter	760	925	40%
Kapter	680	820	40%
Rreshter	560	655	40%
Tetar	455	560	40%
Nëntetar	405	505	40%